

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 16.12.2021
Numri i protokollit:
07Nr.666/350-66372

-Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës, në bazë të kërkesës së Samir Hoxhaj-t-Drejtor i QRTK-së Prizren 07Nr.350-66372 të datës: 25.10.2021 në të cilën kërkon dhënjen e lejes për ndërhyrje emergjente në Xhaminë e Gazi Mehmet Pashës në fshatin Leshan, Komuna e Suharekës, në bazë të të nenit 5, 14 dhe 21 të Ligjit të Ndërtimit Nr.04/L-110, nenit 3, 31, 36 dhe 42 të rregullorës mbi rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve 01 Nr-16-423 datë 26.01.2011, nenit 35 dhe 114 të Vendimit për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe shërbimeve komunale në teritorin e Komunës së Suharekës 01 Nr. 109/2001 të datës 16.03.2001 si dhe nenit 44, 47, 48 e 125 të LPA-së, duke u mbështetur edhe në PZHK-në, 01-Nr-016-67691 datë 29.10.2021 bie këtë:

PËLQIM

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	z.Samir Hoxhaj – Drejtor i QRTK-së Prizren	Nr. Personal	-
Adresa:	QRTK Prizren	Telefoni:	044/453 093
Email :	/	Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje emrgjente për masa preventive në Xhaminë e Leshanit 07Nr.350/66372 datë: 25.10.2021



I LEJOHET- z.Samir Hoxhaj-t drejtor i QRTK-së në Prizren, kryerja e punimeve ndërtimore emergjente në sanimin e Objektit të Xhamisë së fshatit Leshan të Komunës së Suharekës me katshmeri PL+0 në rrugën “Destan Bytyçi” në parcelën kadastrale 00411-0 me numër referues të çertifikatës 11-1902-2021 datë 25.10.2021, Zona Kadastrale Leshan, pronë e Bashkësisë Islame Leshan Suharekë.

Të gjitha punimet ndërtimore për ndërhyrje emergjente në Objektin e Kultit të fesë Islame – Xhamisë së fshatit Leshan me etazhitet P+0 të realizohen sipas paramasave dhe parallogarive si dhe raportit të gjendjes egzistuese të Xhamisë së fshatit Leshan (me Nr. protokoli 376/3 datë 11.11.2021) të dorëzuara së bashku me kërkesën 07 Nr.350/66372 të datës 25.10.2021.

Objekti ka gabarit- dimensione egzistuese: 13.28m’x 8.93m’ me etazhitet P+0 (përdhesë e lartë) e qe nuk guxon të preket konstruksioni e as të ndryshohet gabariti i tij.

Investuesi është i obliguar të i përmbahet paramasës dhe parallogarisë si dhe raportit të cituar më lartë gjatë zhvillimeve të punimeve të cilat duhet të mbikqyren në vazhdimësi nga parashtuesi i kërkesës dhe inxhinjeri përkatës për lamin e ndërhyrjes në objekte. Intervenimet në objekt të kryhen në përputhje me dispozita ligjore në fuqi duke pasur parasysh sigurinë e faktorit njeri dhe objektin.

Zhvillimin e punimeve do të bëhen nën mbikqyerjen Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë Prizren.

Me këtë pëlqim lejohej pastrimi i oborrit dhe terenit në tërësi nga mbeturinat e krijuara gjatë zhvillimit të punimeve. Mbeturinat e ndryshme duhet të transportohen në deponi legale të qytetit nën mbikqyerjen e inspektionit kompetent të Komunës.

Për çdo rrezikim të stabilitetit të objektit –Xhamisë përgjegjësinë e bartë investesi dhe stafi mbikqyerës i objektit.

Gjatë kryerjes së punimeve punkryesi vendin ndërtimor duhet ta siguron në mënyrë të vulltshme në pajtim me dispozitat e mbrojtjes në punë, sipas Vendimit të cekur më lartë pëmirëmbajtjen e pastertisë dhe shërbimeve Komunaletë territorin e Komunës së Suharekës.

Gjatë kryerjes së punimeve investuesi gjegjësisht kryesi i punimeve është i obliguar që të i përmbahet rregullave teknike –ndërtimore dhe pas përfundimit të punimeve vendin e nërtimit ta kthejë në gjendjen e mëparshme.

Investuesi është i obliguar para fillimit të punimeve emregjente në sanimin e Objektit të Xhamisë ta njoftoni Drejtorinë e Inspektionit për fillimin e punimeve.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës 07 Nr.350-66372 të datës 25.10.2021 nga Samir Hoxhaj – Drejtor i QRTK-së Prizren në të cilën kërkon dhënjën e lejeës për intervenim emergjent në sanimin dhe marrjen e masave preventive në parandalimin e degradimit të mëtutjeshëm në aspektin e stabilitetit konstruktiv të Xhamisë së fshatit Leshan dhe parandalimin e rrenimit të tij nga faktori kohë, për të kriju qëndrushmeri të strukturës dhe të shfrytëzohet si Objekt Kulti (i fesë Islame) edhe më tutje.

Ky organ përmes shërbimit të vet teknik e pas shqyrtimit të kërkesës, plotësimit të lëndës ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës mund të i jepet leja ndërtimore gjegjësisht Pëlqimi për kryerjen e punimeve të lartëpërmendura.

Në bazë të nenit 8.14 Dispozitat e veqanta të rregullorës(dispozita lehtësuese) mbi tarifat dhe ngarkesat, nuk do të paguhet taksë në këtë rast konform nenit 8.14.3 për objektet e kultit fetar, të rregullorës Nr-16-12102 të datës 01.12.2015, andaj edhe ky objekt lirohet nga pagesa e taksës.



Udhëzime Juridike: Kundër këtij Pëlqimi pala e paknaqur ka të drejtë ankese MMPH-së në Pishtinë, përmes kësaj Drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të te njëjtit.

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal, Dosjes së DUP-së

Zyrtari:

Sedat Bytyçi, inxh.dip. ndërtim.



Faqe 2 nga 2

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 022 Suharekë - Kosovë

Telefon: 029 271 318

www.komunaesuharekes.com E-mail: komunaesuharekes@gmail.com